



ETAT DE FRIBOURG
STAAT FREIBURG

Ecole primaire du Schoenberg
Route de la Heitera 17, 1700 Fribourg

Service de l'enseignement obligatoire de langue
française SEnOF
Amt für französischsprachigen obligatorischen
Unterricht FOA

Ecole primaire du Schoenberg
Route de la Heitera 17
1700 Fribourg

T +41 26 352 91 51
www.epschoenberg.friweb.ch

—

Prindërve të nxënësve
të klasave 1^H-8^H

Direction : Samuel Glannaz
E-Mail : dir.ep.schoenberg@edufr.ch

Fribourg, 21 janar 2022

Prezantimi i Klapp si mjet komunikimi mes shkollës e prindërve nga 21 janari 2022

Të dashur prindër,

Komunikimi mes shkollës dhe prindërve është i rëndësishëm.

Ne dëshirojmë që komunikimi të jetë efikas.

Me **Klapp**, mësuesit dhe drejtorja e shkollës ju dërgojnë informacione, takime dhe letra lehtësisht në telefonin tuaj, tabletën ose kompjuterin tuaj.

Dokumentet që kanë nevojë për t'u firmosur do të sillen në shtëpi nga fëmija juaj.

Klapp përdoret

- Për t'ju komunikuar shpejt informacione të rëndësishme.
- Për të organizuar takime.
- Për t'i bërë një kërkesë mësuesit ose drejtorit.
- Për t'i dërguar mësuesit një dokument.

Klapp zëvendëson Whatsapp, SMS dhe e-mail-et.

Është e rëndësishme që të gjithë prindërit të instalojnë Klapp. Ju mund të vendosni nëse vetëm njëri prind, të dy ose persona të tjerë përgjegjës duhet të marrin informacione në **Klapp**.

—

1. Regjistrohuni në **Klapp** deri më 25 shkurt 2022. Shkarkoni aplikacionin **Klapp falas** në telefonin tuaj ose shkoni te faqja e internetit www.klapp.mobi.
2. Krijoni një llogari.
3. **Klapp** do t'ju dërgojë një e-mail me të cilin ju duhet të konfirmoni llogarinë tuaj. Nëse nuk mund ta gjeni këtë e-mail, kontrolloni edhe e-mail-et e padëshiruara.
4. Vendosni kodin e nxënësit të fëmijës suaj.
5. Ju mund të vendosni nëse dëshironi që persona të tjerë të shohin numrin tuaj të telefonit apo jo.

Nëse nuk arrini të regjistroheni, ju mund të kërkontë ndihmë në 079 663 90 35.

Ne jemi shumë të lumtur që marrim pjesë në projektin **Klapp** dhe shpresojmë të jemi në gjendje t'ju propozojmë një komunikim të thjeshtë e dixhital.

Përshëndetje miqësore,



Samuel Glannaz
Directeur de l'école primaire du Schoenberg



Marie-Laure Vonlanthen
Service de l'enfance, des écoles et de la cohésion
sociale de la Ville de Fribourg

Më shumë informacione rreth **Klapp** do të gjeni në adresën : www.klapp.pro.

Lidhje të dobishme :

Mbështetje - <https://support.klapp.mobi/de/>

Hapat e parë - <https://support.klapp.mobi/de/eltern/registrierung>

Regjistrimi - <https://support.klapp.mobi/de/article/installation-und-registrierung>

Më shumë fëmijë - <https://support.klapp.mobi/de/article/mehrere-kinder>

Në aneks:

Deklarat për mbrojtjen e të dhënave

Kodi i autorizimit

Getting Started international

Deklarata për mbrojtjen e të dhënave



Klapp GmbH

Föhrenstrasse 1
5442 Fislisbach
032 510 08 38 | www.klapp.pro

Bashkëpunëtorët e Klapp veprojnë në përputhje me parimin e politikës së privatësisë së Klapp dhe i trajtojnë të dhënat në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të fshehtë.

Si çdo lloj platforme interneti dhe aplikacioni celular, ne kemi nevojë për disa të dhëna personale për krijimin e llogarisë suaj të përdoruesit.

Të dhënat mbliidhen dhe përpunohen për qëllime identifikimi, dhe nuk do të përdoren për tjetër gjë. Ne i respektojmë rreptësisht parimet e mëposhtme:



Ne nuk duam të fitojmë para me të dhënat tuaja. Ne ju garantojmë që të dhënat e përdoruesit nuk do t'u shiten kurrë palëve të treta ose nuk do të përdoren për qëllime publiciteti.



Ne i menaxhojmë të dhënat e përdoruesit me masë (privacy by design). Ne kujdesemi që të mos mbliidhen të dhëna të panevojshme, për të mbrojtur sa më shumë privatësinë e çdo përdoruesi.



Ne i ruajmë dhe i përpunojmë të dhënat tuaja në Zvicër. Partnerët tanë respektojnë rregulloret zvicerane dhe evropiane për mbrojtjen e të dhënave.



Klapp mundëson vetëvendosjen për informacionet. Çdo përdorues vendos vetë se cilat të dhëna dëshiron t'i ndajë me përdoruesit e tjerë.



Nuk ka regjistrim të sjelljes së përdoruesit gjatë kërkimit në internet. Për të mbrojtur privatësinë e përdoruesve, Klapp nuk regjistron sjelljen e përdoruesve gjatë kërkimit.

Në deklaratën tonë të privatësisë (<https://fr.klapp.pro/datenschutz?lang=fr>), ne informojmë përdoruesit tanë (mësuesit, përgjegjësit e shkollave, nxënësit, prindërit, anëtarët e shoqatës, ...) për të dhënat personale që ruajmë për ta, për mënyrën se si i përdorim këto të dhëna dhe, në rast nevojë, me kë mund t'i ndajmë ato. Ju do të gjeni gjithashtu informacione mbi të drejtat që ju keni mbi përdorimin e të dhënave tuaja.

Nëse keni ndonjë pyetje mbi mbrojtjen e të dhënave ose nëse dëshironi të kërkoni fshirjen e të dhënave tuaja, ju lutemi të kontaktoni korrespondentin tonë për mbrojtjen e të dhënave duke i dërgues një e-mail në info@klapp.pro.

Adresa e plotë e të ngarkuarit tonë për mbrojtjen e të dhënave është :
Klapp Sàrl | Elias Schibli | Föhrenstrasse 1 | CH-5442 Fislisbach

Kodi i autorizimit Klapp

Shkolla :.....
Nxënësi :.....
Kodi i autorizimit :.....

E rëndësishme: Ju lutemi ruajeni këtë dokument në një vend të sigurtë, sepse kodi mund të përdoret gjithashtu për të hapur llogari shtesë. Për shembull është rasti, kur edhe prindi tjetër don të lidhet me të njëjtin fëmijë.

Lidhja e parë pas krijimit të llogarisë suaj Klapp

1. Hyni me adresën tuaj të e-mail-it dhe fjalëkalimin tuaj.
2. Plotësoni të dhënat tuaja personale. Ky hap i fundit do të finalizojë regjistrimin tuaj.
3. Tani keni akses në lajmërimet, dokumentet dhe ngjarjet shkollore përmes Klapp. Ju do të njoftoheni me elementet e reja me një njoftim "push" ose një e-mail.

⚠ LIDHJE SHITESË – Nëse keni marrë kode të tjera autorizimi, ju mund t'i hapni në çdo moment nën "Classes" me (+).

Shënim: Disa pajisje (telefon/tabletë) mund të përdoren me të njëjtën llogari Klapp.

Informacione të mëtejshme do të gjeni në faqen tonë të internetit www.klapp.pro. Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me aplikacionin Klapp, ju mund të kontaktoni ekipin tonë:
032 510 08 38 | support@klapp.pro | nga e hëna në të premte, nga ora 08h00 deri në 12h00 | 13h00 deri në 17h00